amf ALBANIA

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR NUMRI 93 | PRILL 2016

VËSHTRIM MBI TREGJET

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2016
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2016
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Zhvillohet raundi i 7-të i negociatave të marrëveshjes së CEFTA-s në lidhje me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve
- Seminar mbi koordinimin e politikave për stabilitetin financiar
- Trajnimi i 26-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë
- Seminar mbi shoqëritë dhe grupet e sigurimit me rëndësi sistemike
- Forum Ndërkombëtar i Sigurimeve
- Takim për çështje të veçanta në mbikëqyrjen e aktiviteteve të UNIQA Group Austria organizuar nga Autoriteti i Tregut Financiar, Austri
- Seminari rajonal për mbikëqyrësit e sigurimeve

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

- Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE)
- Moldavi
- Turqi
- Botim - EIOPA
- Rumani
- Ukrainë
- Botim - IOSCO

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Parimet e nivelit të lartë të G20 për mbrojtjen e konsumatorit (Pjesa e dytë)

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm ju lutemi na kontaktoni:

Rruga "Dora Distra",Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-mars 2016 kapën vlerën mbi 2,94 miliardë lekë, ose 2.70% më pak se gjatë periudhës janar-mars 2015. Gjatë periudhës janar-mars 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 222,422 me një ulje prej 1.29% krahasuar me periudhën janar-mars 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.67% të tregut të sigurimeve.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 14.10% në krahasim me periudhën janar-mars 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 0.56 miliardë lekë, apo 69.51% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 2.82% gjatë periudhës janar-mars 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-mars 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 1.83 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2016, duke shënuar një rritje prej 2.19% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.67% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 16.28% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.23% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 9.46% krahasuar me periudhën janar-mars të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori”, e cila përbën 55.42% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-mars 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2016

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2016 ishte 13,419 anëtarë duke shënuar rritje prej 6.85% krahasuar me fundin e vitit 2015.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.03.2016 tregon një total asetesh neto prej 1,020.13 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 91.39 milionë lekë (9.84%) krahasuar me fundin e vitit 2015. E shprehur në euro, (sipas kursit zyrtar të këmbimit më 31 mars 2016, 1 euro = 138.77 lekë) totali i aseteve neto është 7.35 milionë euro.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2016 ishte 13,419 anëtarë duke shënuar rritje prej 6.85% krahasuar me fundin e vitit 2015.

Tregues të fondeve të pensioneve

Përshkrimi	***Vlera*** *(mln. lekë)*		***Ndryshimi*** *(Në %)*
	31.12.'15	*31.03.'16*	*31.12.'15-31.03'16*
Asetet neto të FP	928.74	1,020.13	9.84

Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

31.03.2016

Fond Pensioni	***Numri i anëtarëve në FP***	***Asete Neto*** *(mln. lekë)*
SIGAL	5,561	509.63
RAIFFEISEN	2,616	348.56
SiCRED PENSION	5,242	161.95
TOTAL	**13,419**	**1,020.13**

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve,

31.03.2016
(Në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve,

31.03.2016
(Në %)



Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2016

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2016 u dominua në masën 77.09% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 22.91% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 94.25% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2016 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 64.71% dhe 19.88% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.70% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.



Krahasuar me periudhën janar-mars 2015, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth1,000 milionë lekë.

*

A. Blerje në tregun primar
B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
C. Blerje para afatit të maturimit
D. Vendosje e bonos si kolateral
E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" gjatë periudhës janar-mars 2016, ka pasur një rritje prej 895 milionë lekë ose 77.88% krahasuar me periudhën janar-mars 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 163.98%.

Transaksioni i llojit C "Blerje para afatit të maturimit" gjatë periudhës janar-mars 2016 ka pasur një rritje prej 105 milionë lekë ose 14.88% krahasuar me periudhën janar-mars 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 12.81%.

Krahasuar me periudhën janar-mars 2015, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1,000 milionë lekë.

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale *(në mln lekë)*		Ndryshimi *(në %)*
Periudha		**2015**	**2016**	**`16/`15-1**
B	**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**	**1,228.55**	**2,123.87**	**72.88**
	Individë	*931.51*	*1,956.87*	*110.08*
	Persona juridike	*297.04*	*167*	*(43.78)*
C	**Blerje para afatit të maturimit**	**705.64**	**810.61**	**14.88**
	Individë	*646.14*	*710.61*	*9.98*
	Persona juridikë	*59.50*	*100.00*	*68.07*

Zhvillohet raundi i 7-të i negociatave të marrëveshjes së CEFTA-s në lidhje me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve

Për sektorin financiar jobankar oferta e paraqitur nga AMF, ishte e bazuar në regjimin aktual të kufizimeve dhe detyrimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon këto shërbime.

Në datat 5-6 prill 2016 në Podgoricë, Mali i Zi u zhvillua raundi i 7-të i negociatave të marrëveshjes së CEFTA-s në lidhje me liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve në rajon. Negociatat përfshinin shërbimet financiare, bankare e jobankare, shërbimet e transportit, si edhe shërbimet audiovizive. Pjesëmarrës në diskutimet e negociatave ishin vendet e rajonit, anëtarë të CEFTA-s, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Serbia dhe Shqipëria.

Në këtë raund bisedimesh Shqipëria u përfaqësua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për pjesën e shërbimeve financiare jo bankare.

Diskutimet e pjesëmarrësve në negociata u përqendruan në skedulin e angazhimeve të paraqitur paraprakisht nga çdo shtet pjesëmarrës në marrëveshjen e CEFTA-s, si dhe në përcaktimin e ngjashmërive dhe pikë-prerjeve të kuadrit ligjor të çdo shteti pjesëmarrjes duke u fokusuar në mundësinë e liberalizimit përkatës në tregtinë e shërbimeve në rajon.

Për sektorin financiar jobankar oferta e paraqitur nga AMF, ishte e bazuar në regjimin aktual të kufizimeve dhe detyrimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon këto shërbime, sipas shkresës zyrtare të dërguar nga AMF në MZHETTS në mars 2016 mbi skedulin e angazhimeve të CEFTA-s.

Negocimi i marrëveshjes së CEFTA-s do të vazhdojë edhe në raunde të tjera bisedimesh, përderisa nuk u arrit në një konkluzion dhe në një ofertë konkrete shumëpalëshe, gjatë diskutimeve në këtë raund.

Seminar mbi koordinimin e politikave për stabilitetin financiar

Qendra e Ekselencës Financiare (ECF) e Ministrisë së Financave të Sllovenisë zhvilloi në datat 12-15 prill 2016, seminarin mbi koordinimin e politikave për Stabilitetin Financiar.

Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues nga bankat qendrore, ministritë e financave dhe rregullatorë të tjerë të tregut financiar të përfshirë në formulimin dhe zbatimin e politikave të stabilitetit financiar dhe politikat makroekonomike.

Kriza financiare globale dhe pasojat e saj të gjera që kanë prekur ekonomitë në të gjithë rajonin, kanë theksuar rëndësinë kritike të koordinimit ndërmjet politikëbërësve për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të menaxhuar dhe zgjidhur në mënyrë efektive krizën.

Kriza financiare globale dhe pasojat e saj të gjera që kanë prekur ekonomitë në të gjithë rajonin, kanë theksuar rëndësinë kritike të koordinimit ndërmjet politikëbërësve për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të menaxhuar dhe zgjidhur në mënyrë efektive krizën.

Ky seminar i ndërtuar nëpërmjet një rasti studimi konkret, ishte projektuar me qëllim nxitjen e shkëmbimit të njohurive mes praktikuesve të angazhuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Kombinimi i prezantimeve praktike nga bankat qendrore dhe institucionet financiare ndërkombëtare aktive në rajon me rastin e studimit mundësoi një qasje interaktive të të mësuarit. Nëpërmjet këtij të fundit, pjesëmarrësit simuluan një grup pune të ndarë në ekipe, ku secili ekip përfaqësonte rolin e një banke qendrore, autoriteti mbikëqyrës financiar apo ministrisë së financave për të treguar këndvështrimet e ndryshme që këto institucione kanë në koordinimin e politikave të stabilitetit financiar.

Një fokus të veçantë pati trajtimi i politikave kryesore makroekonomike me të cilat përballen autoritetet rregullatore në ekonomitë në zhvillim dhe ato të zhvilluara, si dhe alternativat e vlefshme të vendimmarrësve në këto vende, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve se si këto politika makroekonomike bashkëveprojnë me politikat mikroekonomike të zbatuara në mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

Gjatë seminarit u ngrit çështja e ndërveprimit të autoriteteve mbikëqyrëse të tregjeve të ndryshme financiare dhe nevoja e një fokusi më të madh ndaj institucioneve financiare jobankare, si institucione me një peshë të rëndësishme në rritje në ekonominë globale.

Trajnimi i 26-të ndërkombëtar mbi zhvillimin e tregut të letrave me vlerë

Komisioni i Letrave me Vlerë në SHBA *(Securities Exchange Commission, SEC)* zhvilloi gjatë periudhës 4-14 prill, në Uashington trajnimin e 26-të ndërkombëtar mbi rritjen dhe zhvillimin e tregut të letrave me vlerë *(26th International Institute for Securities Market Growth and Development)*.

Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues nga shumë autoritete të ndryshme rregullatore nga vende të ndryshme të botës. Përfaqësues të SEC si Komisioneri Michael S.Piwowar dhe Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, Paul A. Leder, uruan mirëseardhjen dhe bënë hapjen e aktivitetit. Zëvendës Presidenti i Bankës Botërore Arunma Oteh mbajti fjalimin, "Leksione mbi ngritjen e Tregjeve në Zhvillim."

Duke u nisur nga zhvillimet më të fundit, periodiciteti vjetor i programit, larmia e institucioneve dhe shtetet e përfaqësuara, pozicionet e pjesëmarrësve, programi kishte një spektër të gjerë, pikënisjeje dhe role të ndryshme, por të gjithëpërfshira.

Duke u nisur nga zhvillimet më të fundit, periodiciteti vjetor i programit, programi kishte një spektër të gjerë, pikënisjeje dhe role të ndryshme, por të gjithëpërfshira.

Fjalimet, leksionet, praktikat më të mira, mësimet e nxjerra nga eksperiencat e ndryshme, konsistonin në sa vijon:

- Menaxhimi i një programi efektiv transparence;
- Hartimi i një programi ekzaminimi për ndërmjetësit (Broker-Dealers) dhe këshilltarët e investimeve;
- Leksione mbi Qeverisjen e Korporatave;
- Tregjet e Kapitaleve si një instrument për të financuar sektorët strategjikë të ekonomisë;
- Struktura optimale e tregut dhe roli i tregtimit të kompjuterizuar;
- Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve të ligjit në tregun e letrave me vlerë;
- Manipulimi i tregut dhe zbulimi i mashtrimeve;
- Zhvillimi i një programi informues.

Në mënyrë të posaçme veçohen nga programi tema të tilla si ato për praktikat më të mira vetërregulluese për mbikëqyrjen me bazë risku, rregullimin e fondeve të përbashkëta dhe kompanive të investimeve, bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet e zbatueshmërisë së vendimeve, edukimi i investitorëve, hetimi dhe ndjekja penale për abuzuesit e tregut, hetimi dhe ndjekja penale për skemat e mashtrimit, skemat Ponzi dhe skemat piramidale.

Gjatë seancave të trajnimit u diskutua edhe për ndërtimin e programeve lidhur me etikën e brendshme në autoritetet rregullatore, luftën kundër pastrimit të parave në tregjet e kapitaleve, çështjet ligjore, letrave me vlerë, auditimin në tregjet e kapitaleve, financimin e SME-ve në tregjet e kapitalit, etj.

Seminar mbi shoqëritë dhe grupet e sigurimit me rëndësi sistemike

Në datat 5–7 prill 2016 në Bazel, Zvicër, u zhvillua seminari "Mbi grupet e sigurimit, shoqëritë e sigurimeve të rëndësishme globalisht dhe rezolutën" *(Seminar on insurance groups, global systemically important insurers and resolution)* me pjesëmarrjen e mbikëqyrësve nga vende të ndryshme të botës, si Austri, Çeki, Gjermani, Indonezi, Irlandë, Kanada, Katar, Korea e Jugut, Kuroçao, Malajzi, Poloni, Rusi, Singapor, SHBA, Turqi dhe Zvicër. Ky seminar u organizua nga Instituti i Stabilitetit Financiar *(Financial Stability Institute)*.

Prezantimi dhe identifikimi i grupeve të sigurimeve me rëndësi sistemike, G-SII, ishte një nga temat me interes të trajtuara ne seminar.

Temat që u trajtuan gjatë seminarit ishin:

- Standardet globale mbi mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit;
- Prezantimi dhe identifikimi i grupeve të sigurimeve me rëndësi sistemike, G-SII;
- Mbikëqyrja e G-SII;
- Mbikëqyrja e gjerë e grupeve të sigurimeve në praktikë, e parë kjo nga pikëpamja e shoqërive mëmë;
- Mbikëqyrja e gjerë e G-SII, grupet, konglomeratet financiare, kërcënimet ndaj grupeve të sigurimit; rimëkëmbja dhe rezoluta për shoqëritë e sigurimit ndërkufitar.

Trajnues në këtë seminar ishin drejtues të lartë të Shoqatës Ndërkombëtarë të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, drejtues të shoqërive të konsulencës, përfaqësues të autoriteteve rregullatore të vendeve të zhvilluara evropiane, si edhe shoqëri sigurimesh të zhvilluara.

Forum Ndërkombëtar i Sigurimeve

Në datat 17-19 prill 2016, në Stamboll, Turqi u zhvillua Forumi i Gjashtë Ndërkombëtar i Sigurimeve me temë “Sigurimet motorike-rruga drejt përfitueshmërisë”. Ky aktivitet u organizua nga Media XPRIMM në bashkëpunim me Qendrën e Sigurimeve të Stambollit, IUC (Istanbul Underwriting Center) dhe me mbështetjen e Shoqatës së Sigurimeve të Turqisë, TSB (Insurance Association of Turkey). Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të lartë të tregut tësigurimeve nga vende të ndryshme të Evropës dhe rajonit. Kështu të pranishëm ishin drejtues të politikave të përgjithshme të sigurimit të organizatës sësigurimeve britanike, drejtues të byrove të sigurimeve motorike, menaxherë dëmesh, presidentë të agjencive të sigurimeve, menaxherë të risigurimit, kryetarë të bordit ekzekutiv të byrosë së sigurimeve motorike, aktuarë, juristë, etj.

Zhvillimet më të fundit mbi çështjet ligjore dhe rregullative lidhur me sigurimet motorike, shanset dhe sfidat e këtyre sigurimeve si dhe teknologjitë e reja në mbështetje të segmentit të sigurimeve motorike ishin ndër temat e analizuara gjatë Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve, 2016.

Zhvillimet më të fundit mbi çështjet ligjore dhe rregullative lidhur me sigurimet motorike, shanset dhe sfidat e këtyre sigurimeve si dhe teknologjitë e reja në mbështetje të segmentit të sigurimeve motorike ishin ndër temat e analizuara gjatë Forumit Ndërkombëtar të Sigurimeve, 2016.

Aktiviteti ishte i konceptuar mbi bazën e prezantimeve të përgatitura nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës së sigurimit MTPL, nga disa panele diskutimi, si dhe diskutime në tryezë të rrumbullakët me fokus sigurimin motorik.

Në ditën e parë të konferencës u diskutuan këto tema kryesore:

- Problematikat aktuale në industrinë e sigurimit motorik;
- Tregjet e CEE & CIS – prirjet dhe sfidat;
- Përfitueshmëria në industrinë e sigurimit motorik.

Në panelet e diskutimit u sqaruan çështjet mbi:

- Prirjet e sigurimit motorik në vendet e Evropës lindore dhe juglindore;
- Vendosjen e çmimeve të drejta si një sfidë e sigurimit motorik;
- Përmirësimin e përfitueshmërisë së tregut në sajë të menaxhimit më të mirë të dëmeve.

Lufta ndaj mashtrimit në sigurimin MTPL, menaxhimi i dëmeve dhe sigurimi MTPL si një treg në zhvillim, ishin temat kryesore, në të cilat u fokusua dita e dytë e konferencës, ku u ndanë edhe praktikat më të mira në zbulimin e mashtrimeve në sigurimin motorik. Gjatë ditëve të zhvillimit të saj, konferenca shërbeu si një platformë për krijimin e një *Networking*.

Në takim u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dhe mbikëqyrjen e grupit.

Takim për çështje të veçanta në mbikëqyrjen e aktiviteteve të UNIQA Group Austria organizuar nga Autoriteti i Tregut Financiar, Austri

Në datë 20 prill 2016, në Vjenë, Austri u zhvillua takimi për çështje të veçanta në mbikëqyrjen e aktiviteteve të UNIQA Group organizuar nga Autoriteti i Tregut Financiar të Austrisë, (FMA) me ftesë të Dr. Peter Braumuller, Drejtor i Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit dhe Pensioneve. Pjesëmarrësit ishin mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit pjesë e grupit financiar “UNIQA”, respektivisht drejtues të lartë të mbikëqyrjes në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri.

Takimi kryesisht konsistoi në:

- Prezantimin e aktiviteteve ndërkufitare të UNIQA Group nga perspektiva e mbikëqyrësit të Grupit;
- Zhvillimet e fundit në lidhje me UNIQA Group;
- Përmbledhje e gjetjeve të fundit në lidhje me aktivitetet e UNIQA Group në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni;
- Hapat e ardhshëm për forcimin e bashkëpunimit dhe mbikëqyrjen e grupit;
- Të ndryshme.

Seminari rajonal për mbikëqyrësit e sigurimeve

Seminari rezultoi tepër i vlefshëm për arsye se hapi më tepër horizon-tin mbi mbikëqyrjen me bazë rreziku, duke pasur gjithmonë si kontekst *"Solvency II".*

Në datat 26-28 prill 2016, në Vilnius të Lituanisë, u zhvillua seminari rajonal për mbikëqyrësit e sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, Transkaukazinë dhe Azinë Qendrore lidhur me mbikëqyrjen dhe menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjeve nga siguruesit. Seminari u organizua nga Banka e Lituanisë në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) dhe Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI dhe BIS). Prezantuesit ishin ekspertë dhe drejtues nga IAIS, FSI (BIS), Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë, BaFin. Prezantime kishte edhe nga drejtues e përfaqësues nga shoqëri sigurimesh në Lituani dhe në Republikën Çeke.

Pjesëmarrësit vinin nga autoritetet mbikëqyrëse të tregut të sigurimeve si: Armenia, Estonia, Hungaria, Kosova, Lituania, Letonia, Maqedonia, Mali i Zi, Polonia, Republika Çeke, Rusia, Sllovenia, Shqipëria, Turqia.

Prezantimet kryesisht konsistuan në:

- Mbikëqyrjen me bazë rreziku dhe ruajtjen e stabilitetit financiar bazuar në standardet ndërkombëtare;
- Përcaktimin e burimeve dhe kërkesave për kapital në lidhje me rrezikun sistemik dhe stabilitetin financiar, si edhe prezantimin e një standardi global përsa i përket kapitalit për sigurimet;
- Trajtimin e rreziqeve nga pikëpamja teknike në procesin e identifikimit, matjes, vlerësimit, provave të rezistencës, skenarëve, të korelimit dhe të diversifikimit të tyre;
- Menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjeve (ERM) dhe të vet vlerësimit të rrezikut për aftësinë paguese (ORSA) në nivel grupi në lidhje me vendimmarrjen dhe menaxhimin strategjik bazuar në oreksin për rrezik të aksionerëve;
- Rolin e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve në një strukturë të aftë sisë paguese me bazë rreziku dhe kërkesat rregullative;
- Menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjeve dhe vlerësimin e rrezikut të aftë sisë së vet paguese në kuadrin e *"Solvency II"*.

Gjatë seminarit u diskutuan edhe rastet studimore për vlerësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut të një siguruesi dhe grupit të tij. Ky seminar rezultoi tepër i vlefshëm për arsye se hapi më tepër horizontin mbi mbikëqyrjen me bazë rreziku, duke pasur gjithmonë si kontekst *"Solvency II"* ndërkohë që u shkëmbyen informacione rreth eksperiencave të vendeve të ndryshme.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE)

www.xprimm.com

Volumi i përgjithshëm i primeve të sigurimit të Jo-Jetës u rrit me rreth 5% në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke arritur në 18.76 miliardë euro në vitin 2015. Edhe klasat e sigurimit të mjeteve motorike patën dinamikë rritëse, me rritje prej 5%, duke arritur në 9.42 miliardë euro dhe gjeneruar pak më shumë se gjysmën e rritjes totale absolute. Megjithatë, ky sektor është ende larg vlerave të larta të ritmeve të rritjes që kishte përpara krizës.

Me pak përjashtime, linjat e sigurimit MTPL patën një performancë më të mirë se sigurimi Kasko, duke regjistruar një përqindje totale rritjeje prej 5.55% në nivel rajonal:

- Pjesa më e madhe e tregjeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore regjistruan një dinamikë pozitive rritje të segmentit të sigurimit të mjeteve motorike, me përjashtim vetëm të Kroacisë dhe Sllovenisë. Të dy këto vende ishin të prekura, në masë të ndryshme, nga konkurrenca e çmimeve;
- Vetëm pak tregje si Shqipëria, Kosova, Serbia, Hungaria patën rritje në përqindje dyshifrore, duke arritur dinamikën e përpara krizës. Nxitësit kryesorë të zhvillimit ishin tarifat e rritura të sigurimit, shitjet më të mëdha të automjeteve, si dhe një mbulim më i mirë i gjithë automjeteve të regjistruara;
- Në Bullgari dhe Rumani rritja e primeve të shkruara bruto të sigurimit motorik ishte rreth 10%. Në Bullgari, rritja ishte kryesisht për shkak të tendencës pozitive të regjistruar në segmentin e sigurimit Kasko, ndërsa në Rumani faktori kryesor i rritjes ishte rritja e konsiderueshme e tarifave MTPL.

Pagesat e dëmeve u rritën me një ritëm më të lartë sesa primet, prej 12.3%, sidomos në trajtimin e dëmeve nga MTPL. Kroacia pati dinamikën më të ulët të pagesës së dëmeve, ndërsa Polonia ishte vendi me rritje të vlerave të dëmeve krahasuar me vitet e mëparshme.

Moldavi
www.xprimm.com

Sipas statistikave paraprake të publikuara nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut moldav në fund të vitit 2015, tregu moldav i sigurimeve arriti një total prej 1.2 miliardë MDL (Lei moldav) ose rreth 58.8 milionë euro, duke u rritur me 2.1% në krahasim me vitin e kaluar. Dëmet e paguara nga 15 sigurues arritën në rreth 386.6 milionë MDL ose 18.5 milionë euro. Kjo vlerë është sa rreth 31% e primeve të shkruara bruto në total.

Sigurimi i Jetës zinte 7% të primeve të shkruara bruto, në total afërsisht 87.5 milionë MDL, ndërsa pjesa tjetër prej mbi 92% e primeve është gjeneruar nga sigurimet e Jo-Jetës. Në sigurimet e Jo-Jetës rreth dy të tretat e primeve të shkruara bruto u siguruan nga sigurimet e mjeteve motorike dhe përkatësisht sigurimi Kasko zinte 19.7%, MTPL 20.4% dhe Kartoni Jeshil 22.2%.

Rumani
www.xprimm.com

Grupi i sigurimeve ndaj katastrofave natyrore i Rumanisë *(PAID, Insurance Pool against Natural Disasters)* në fund të vitit 2015 kishte një rritje prej 7% të volumit të primeve të shkruara bruto dhe fitim bruto prej 25 milionë RON (Lei rumun) ose rreth 5.56 milionë euro. Sikurse njoftoi shoqëria në një deklaratë për shtyp, ky fond do të përdoret për të përmirësuar vetë fondet e kompanisë. “Akumulimi i fondeve, si dhe zhvillimi i programit të risigurimeve, i jep PAID-it burime të mjaftueshme për t’u paguar dëmet të siguruarëve të saj në rast të një ngjarjeje madhore”, shpjegoi Francois Coste, President i Bordit të Menaxhimit, PAID Rumani. Ai theksoi se PAID punon së bashku me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në Rumani, për të identifikuar një mënyrë për të përballuar një tërmet ekstrem, me gjithë primin e ulët të vendosur aktualisht nga ligji rumun, i cili konsiderohet i pamjaftueshëm nga llogaritjet aktuariale.

Në fund të vitit 2015, PAID raportoi një total prej 1.6 milionë policash aktive (polica sigurimi të detyrueshëm për shtëpi, të siguruara nga PAID). Kjo shifër ishte 6.5% më shumë krahasuar me numrin e policave PAID në fund të vitit 2014, dhe me një vlerë të primit të shkruar bruto prej 135 milionë RON, ose 7% më shumë krahasuar me vlerën e raportuar në fund të vitit 2014.

Programi i risigurimeve të PAID ka një mbulim prej 600 milionë euro, tre herë më të madh krahasuar me programin e parë të risigurimeve PAID në kohën e fillimit të tij. Aktualisht ai është programi më i madh në Rumani përsa u takon fatkeqësive natyrore. Cilësia e programit vazhdon të jetë e lartë dhe midis risiguruesëve të përfshirë në të janë edhe kompani të tilla si: Munich Re, Swiss Re, SCOR, Hannover Re, Sirius, XL Re, si dhe anëtarët e Lloyd-it. Të gjithë risiguruesit kanë një klasifikim të paktën "-A".

Turqi
www.xprimm.com

Me rastin e botimit të IIF *(International Insurance Forum)* "Sigurimi i mjeteve motorike – rruga drejt përfitimeve" për vitin 2016, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës së Sigurimeve të Turqisë, Mehmet Akif EROGLU, deklaroi se tregu turk i sigurimeve ka pasur një rritje prej 41% të volumit të primeve të shkruara në (të vlerësuara në USD) në periudhën 2010-2015. Aktualisht industria e sigurimeve ka të punësuar më shumë se 75,000 punonjës.

Ritmi i lartë i zhvillimit, potenciali i tregut si edhe perspektivat e zhvillimit të vendit në të ardhmen kanë tërhequr mjaft investitorë të huaj në sektorin e sigurimeve, kështu që aktualisht 72% e kapitalit të tregut zotërohet nga kompanitë ndërkombëtare.

Sipas autoriteteve turke të sigurimit, sektori turk i sigurimeve, rregullohet dhe mbikëqyret më së miri dhe rregullat që zbatohen në tregun turk të sigurimeve janë në përputhje me normat e BE-së. Autoriteti mbikëqyrës dhe shoqata kanë punuar për zbatimin e regjimit të *Solvency II.*

Sipas zyrtarëve turq, në vitin 2015 rreth 24% e totalit të primeve të shkruara nga kompanitë turke vijnë nga sigurimi MTPL dhe një nga çdo tre polica të shitura në Turqi është një policë MTPL. Më shumë se 15.9 milionë polica MTPL janë shitur në vitin 2015 në vend. Kjo tregon se sigurimi MTPL përfaqëson një burim të rëndësishëm biznesi, por gjithashtu një sfidë të rëndësishme në aspektet e fitimit. Siguruesit shpresojnë se në një të ardhme të afërt akte të reja legjislative do të miratohen për të përfshirë edhe sistemin e kompensimit të drejtpërdrejtë.

Ukrainë
www.xprimm.com

Gjatë pesë viteve të fundit, tregu ukrainas i sigurimeve pati një rritje të qëndrueshme (e shprehur kjo në monedhën vendase), me përjashtim të vitit 2014. Kështu gjatë vitit 2015 volumi i primeve të shkruara bruto të fituara nga siguruesit ka pasur një rritje dyshifrore, me 11.1%. Megjithatë, e shprehur në monedhë evropiane primet e shkruara bruto u ulën me 19%, duke i bërë ekspertët që të vlerësojnë se "në vitin 2015 dinamika nuk ishte impresionuese".

Në të njëjtën kohë, rreth 40% e primeve të shkruara bruto në total u vendosën në risigurime nga kompanitë ukrainase të sigurimeve. Sipas të dhënave zyrtare, numri i kompanive të sigurimit u ul me 5% ose e shprehur në shifër absolute rreth 21 sigurues u larguan nga tregu. Raportet zyrtare vlerësojnë se "në tregun financiar jobankar ishin aktive 361 kompani sigurimi, nga të cilat 49 kompani sigurimi Jete, si dhe 312 kompani të angazhuara në lloje të tjera sigurimesh".

Publikime

EIOPA publikon një udhëzues përgatitor mbi mbikëqyrjen e produkteve dhe qeverisjen

Udhëzuesi përgatitor u kërkon shoqërive të identifikojnë grupet e konsumatorëve për secilin produkt me vete, për ta përshtatur atë sipas interesave dhe objektivave për të siguruar shpërndarjen sipas kanaleve të përshtatshme të produkteve.

https://eiopa.europa.eu

Më 13 prill 2016 Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve *(European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA)* publikoi udhëzuesin përgatitor për mbikëqyrjen e produkteve dhe qeverisjen *(Product Oversight and Governance, POG)*, rregullime që duhet të ndiqen nga siguruesit (prodhuesit e produkteve të sigurimit) dhe shpërndarësit.

- Këto udhëzime japin informacione më të hershme dhe mbështetje në zbatimin e mbikëqyrjes së produkteve dhe qeverisjes (POG), rregullime që duhet të zbatohen sipas direktivës së shpërndarjes në sigurime (Direktiva IDD);
- Udhëzimet minimizojnë rrezikun e dëmit të konsumatorit dhe keqshitjet (mis-selling);
- Udhëzimet nxisin një ndryshim kulturor, i cili u kërkon siguruesve dhe shpërndarësve të fokusohen tek interesat e konsumatorit gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit;
- Rëndësia e "frymës që vjen nga lart" (tone from the top): Menaxhimi ka përgjegjësinë më të lartë për vendosjen e konsumatorëve në zemër të biznesit;
- Shpërndarësve u kërkohet të marrin nga prodhuesit të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me produktet që ata janë duke shitur.

Udhëzuesi përgatitor u kërkon shoqërive të identifikojnë grupet e konsumatorëve për secilin produkt me vete, për ta përshtatur atë sipas interesave dhe objektivave për të siguruar shpërndarjen sipas kanaleve të përshtatshme të produkteve.

Raporti përfundimtar që përmban udhëzuesit dhe vlerësimin e ndikimit të tij mund të shihet në faqen online të EIOPA: https://goo.gl/OkZRle

Publikohet raporti i IOSCO-s “Siguria kibernetike në tregun e letrave me vlerë – perspektiva ndërkombëtare”

Raporti nënvizon çështjet dhe mundësitë që lidhen me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis pjesëmarrësve të tregut dhe rregullatorëve.

https://www.iosco.org

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) publikoi më 6 prill 2016 një raport i cili përshkruan njohuritë dhe perspektivat e ndryshme mbi temën e elasticitetit dhe rreziqeve kibernetike.

Rreziku kibernetik në rritje përbën një problem për integritetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e tregjeve financiare në mbarë botën. Siç përshkruan raporti, rreziku kibernetik nuk është "vetëm një tjetër rrezik", por ai është një fenomen unik, shumë i ndërlikuar dhe që evoluon me shpejtësi. Zhvillimi i shpejtë i teknologjive në tregjet e letrave me vlerë bën që këtij rreziku t’i kushtohet vëmendje e shpejtë dhe e qëndrueshme nga ana e rregullatorëve dhe pjesëmarrësve në treg.

Raporti “Siguria kibernetike në tregun e letrave me vlerë – perspektiva ndërkombëtare” pasqyron një rishikim të qasjeve të ndryshme rregullatore në sigurinë kibernetike dhe mjetet e mundshme që rregullatorët kanë në dispozicion për t'iu përgjigjur rrezikut kibernetik. Raporti gjithashtu përshkruan disa prej praktikave të miratuara nga pjesëmarrësit e tregut.

Përmbajtja e raportit është e ndarë sipas segmenteve të tregjeve të letrave me vlerë:

- Hartuesit e raportimeve;
- Vendet e tregtimit;
- Ndërmjetësit në treg;
- Menaxhuesit e aseteve; dhe
- Infrastruktura e tregut financiar.

Raporti nënvizon çështjet dhe mundësitë që lidhen me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis pjesëmarrësve të tregut dhe rregullatorëve.

Dispozita e edukimit dhe informimit financiar për të thelluar njohuritë dhe kapacitetin financiar të konsumatorit duhet të promovohet,në mënyrë të veçantë për grupet vulnerabël.

Parimet e nivelit të lartë të G20 për mbrojtjen e konsumatorit

http://www.oecd.org/regreform/sectors/financialconsumerprotection.htm

Parimet e renditura më poshtë u janë drejtuar anëtarëve të G20 dhe vendeve të tjera të interesuara. Ato janë hartuar si ndihmë në përpjekjet për të rritur mbrojtjen e konsumatorit financiar. Këto parime janë vullnetare dhe të ndërtuara për të plotësuar dhe jo për të zëvendësuar, parimet financiare ndërkombëtare apo udhëzimet ekzistuese. Në veçanti, ato nuk merren me çështje specifike të sektorit të trajtuara nga organizatat specifike ndërkombëtare dhe përcaktuesit e standardeve financiare të tilla si, BCBS, IAIS dhe IOSCO. Transaksione të llojeve të ndryshme, paraqesin profile të ndryshme të rrezikut. Parimet mund të kërkojnë përshtatje në kontekste të veçanta kombëtare dhe sektoriale dhe duhet të rishikohen periodikisht nga organizmat përkatëse ndërkombëtare.

Të gjithë anëtarët e G20 dhe ekonomitë e tjera të interesuara duhet të vlerësojë kornizat e tyre kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit financiar në dritën e këtyre parimeve dhe të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë drejtim.

Këto parime u miratuan në një dokument final për mbrojtjen e konsumatorit dhe u mbështetën nga Ministrat e Financës dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të G20 tek takimi i tyre në tetor 2011.

Në pjesën e parë u trajtuan parimet:

1. Kuadri ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës ; 2. Roli i organeve të mbikëqyrjes; 3. Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i konsumatorëve; 4. Dhënia e informacionit dhe transparenca.

(pjesa e dytë)

5. Edukimi financiar dhe informimi

Edukimi financiar dhe ndërgjegjësimi duhet të promovohen nga të gjitha grupet përkatëse të interesit. Informacione të qarta për mbrojtjen, të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorit duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme nga konsumatorët. Duhet të zhvillohen mekanizmat e duhur për të ndihmuar konsumatorët aktualë dhe të ardhshëm që të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe besimin për të kuptuar siç duhet risqet, edhe ato financiare, për të bërë zgjedhje të mirinformuara, për të ditur se ku mund të shkojnë për asistencë dhe për të ndërmarrë veprime efikase për të përmirësuar vetë mirëqenien e tyre financiare.

Dispozita e edukimit dhe informimit financiar për të thelluar njohuritë dhe kapacitetin financiar të konsumatorit duhet të promovohet, në mënyrë të veçantë për grupet vulnerabël.

Struktura e pagesës për stafin e ofruesve të shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të inkurajojë drejtimin e përgjegjshëm të biznesit, trajtimin e drejtë tëkonsumatorëve dhe për të shmangur konfliktet e interesit.

Duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare, edukimi financiar dhe informimi duhet të inkurajohen si pjesë e mbrojtjes më të gjerë financiare të konsumatorit dhe e strategjisë së edukimit, duhet të transmetohen nëpërmjet kanaleve të ndryshme dhe të duhura, si edhe duhet të fillojnë në një moshë të hershme dhe të jenë të aksesueshme në të gjitha fazat e jetës. Duhet të synohen programe dhe përqasje specifike në lidhje me edukimin financiar për grupet vulnerabël të konsumatorëve financiarë.

Të gjitha grupet përkatëse të interesit duhet të inkurajohen për të zbatuar parimet dhe udhëzimet për edukimin financiar të zhvilluar nga Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE) i OECD-së. Informacione të mëtejshme të krahasueshme kombëtare dhe ndërkombëtare mbi edukimin dhe informimin financiar duhet të hartohen nga institucionet kombëtare dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare me qëllim që të vlerësojnë dhe përmirësojnë efikasitetin e përqasjeve në edukimin financiar.

6. Drejtimi i përgjegjshëm i ofruesve të shërbimeve financiare dhe agjentëve të autorizuar

Ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të kenë si objektiv, që të punojnë në interesin më të mirë të klientëve të tyre dhe të jenë të përgjegjshëm për mbrojtjen e konsumatorëve. Ofruesit e shërbimeve financiare duhet gjithashtu të jenë të përgjegjshëm për veprimet e agjentëve të tyre të autorizuar.

Në varësi të natyrës së transaksionit dhe mbështetur në informacionet që janë dhënë fillimisht nga klientët, ofruesit e shërbimeve financiare duhet të vlerësojnë kapacitetet financiare përkatëse, situatën dhe nevojat e klientëve të tyre përpara se të bien dakord për t'u dhënë atyre një produkt, këshillë apo shërbim. Stafi (në mënyrë të veçantë ata që ndërveprojnë drejtpërdrejt me klientët) duhet të trajnohen dhe kualifikohen saktësisht. Aty ku ka mundësi për konflikte interesi, ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të bëjnë përpjekje për të shmangur konflikte të tilla. Kur konflikte të tilla nuk mund të shmangen, ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të sigurojnë dhënien e duhur të informacionit, duke vënë në zbatim mekanizma të brendshëm për të menaxhuar konflikte të tilla ose të refuzojnë të japin produkte, këshilla ose shërbime.

Struktura e pagesës për stafin e ofruesve të shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të inkurajojë drejtimin e përgjegjshëm të biznesit, trajtimin e drejtë të konsumatorëve dhe për të shmangur konfliktet e interesit. Struktura e pagesës duhet t'u bëhet e ditur klientëve, kur është e nevojshme, siç është rasti kur konfliktet e mundshme të interesit nuk mund të menaxhohen ose shmangen.

7. Mbrojtja e aseteve të konsumatorit ndaj mashtrimit dhe keqpërdorimit

Informacionet e duhura, mekanizmat e kontrollit e mbrojtjes duhet të mbrojnë siç duhet dhe me një shkallë të lartë sigurie depozitat e konsumatorëve, kursimet, dhe asetet e tjera financiare të ngjashme, duke përfshirë edhe mbrojtjen kundër mashtrimit, shpërdorimit ose keqpërdorimeve të tjera.

Konsumatorëve duhet t'u krijohet mundësia të bëjnë kërkime, të krahasojnë dhe, ku të jetë e përshtatshme, të kalojnë nga një produkt apo ofrues shërbimi tek tjetri në mënyrë të lehtë dhe me kosto të pranueshme dhe të deklaruar.

8. Mbrojtja e të dhënave dhe privatësisë së Konsumatorit

Informacioni financiar dhe personal i konsumatorëve duhet të mbrohet nëpërmjet mekanizmave të duhur të kontrollit dhe mbrojtjes. Këto mekanizma duhet të përcaktojnë qëllimet për të cilat këto të dhëna mund të mblidhen, përpunohen, mbahen, përdoren dhe transmetohen (në mënyrë të veçantë tek palët e treta). Mekanizmat duhet të njohin gjithashtu të drejtat e konsumatorëve për t'u informuar për shpërndarjen e të dhënave, për të aksesuar të dhënat dhe për të kryer korrigjimin e menjëhershëm dhe/ose fshirjen e të dhënave të pasakta, ose të mbledhura ose të përpunuara jo ligjërisht.

9. Përpunimi i ankesave dhe korrigjimi

Juridiksionet duhet të sigurojnë se konsumatorët kanë akses në mënyra të përshtatshme ankimimi, të cilat janë të arritshme, të përballueshme, të pavarura, të drejta, të përgjegjshme, të përpikta dhe efikase. Këto mekanizma nuk duhet të shkaktojnë kosto të paarsyeshme, vonesa apo të bëhen barrë për konsumatorët. Në përputhje me sa më sipër, ofruesit e shërbimeve financiare dhe agjentët e autorizuar duhet të venë në zbatim mekanizma për përpunimin e ankesës dhe korrigjimin e saj. Rekursi i një procesi të pavarur korrigjimi duhet të mundësohet për ankesat të cilat nuk zgjidhen në mënyrë efikase me anë të mekanizmave të brendshëm të zgjidhjes së konflikteve të operatorëve financiare dhe agjentëve të autorizuar. Minimalisht, informacionet e përgjithshme dhe përmbledhëse në lidhje me ankesat dhe zgjidhjet e tyre duhet të bëhen publike.

10. Konkurrenca

Tregjet konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të promovohen me qëllim që t'u japin konsumatorëve zgjedhje më të mëdha midis shërbimeve financiare dhe të krijojnë presion konkurrues mbi ofruesit për të dhënë produkte konkurruese, për të përmirësuar inovacionin dhe për të ruajtur cilësinë e lartë të shërbimit. Konsumatorëve duhet t'u krijohet mundësia të bëjnë kërkime, të krahasojnë dhe, ku të jetë e përshtatshme, të kalojnë nga një produkt apo ofrues shërbimi tek tjetri në mënyrë të lehtë dhe me kosto të pranueshme dhe të deklaruar.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. “Dora D’Istria”, Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al